

**L I G J**  
**Nr.8732, datë 24.1.2001**

**PËR MATERIALIN MBJELLËS BIMOR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**V E N D O S I:**

**KREU I**  
**QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET**

**Neni 1**

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për krijimin, riprodhimin, shumëzimin, përpunimin dhe tregtimin e materialit mbjellës bimor në territorin e Republikës së Shqipërisë.

**Neni 2**

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Atestim” është procedura e punës për pajisjen me certifikatë të një varieteti, kultivari, hibridi ose kloni të ri, për regjistrimin e tij në Regjistrin Themeltar dhe në Katalogun Zyrtar të specieve dhe varieteteve të bimëve bujqësore të kultivuara dhe të bimëve pyjore dekorative.

2. “Bankë gjenetike” është institucioni në varësi të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve që grumbullon, ruan, ripërtërin, studion, vlerëson dhe administron germoplazmën bimore.

3. “Certifikim” është procedura për pajisjen me certifikatë për treguesit sasiorë dhe cilësorë të materialit mbjellës bimor.

4. “Katalogu Zyrtar i specieve dhe varieteteve të bimëve bujqësore të kultivuara dhe të bimëve pyjore e dekorative” është regjistri në të cilin regjistrohen speciet dhe varietetet, materiali mbjellës i të cilave lejohet të riprodhohet, shumëzohet e të tregtohet në Republikën e Shqipërisë. Në të cilësohen varietetet e listës “A” dhe të listës “B”.

5. “Lista A” është regjistri i varieteteve që janë regjistruar në Katalogun e OECD-së (Organizata për Zhvillim e Kooperim Ekonomik).

6. “Lista B” është regjistri i varieteteve të kualifikuara nga Komisioni Shtetëror i Atestimit të Varieteteve dhe regjistruar në Katalogun Zyrtar të specieve dhe varieteteve.

7. “Klon” është një grup bimësh që rrjedhin nga shtimi vegetativ i një bime të vetme.

8. “Komisioni Shtetëror i Atestimit të Varieteteve” është organi që shqyrton dhe kualifikon ose jo varietetet e reja për t'u regjistruar në Regjistrin Themeltar dhe Katalogun Zyrtar të specieve dhe varieteteve.

9. “Material mbjellës bimor” janë farat, fidanët, copat, kalemata, sythat, tuberat, bulbet, kamzat, llastunjat dhe çdo pjesë tjetër e bimëve që shërben për mbjellje dhe riprodhimin e tyre.

10. “Material mbjellës bimor gjenetik” janë popullatat, linjat, incuktlinjat dhe klonet e bimëve bujqësore.

11. “Material mbjellës bimor i ri (i krijuar)” janë kultivarët, linjat prindërore, hibridet dhe klonet e reja të krijuara rishtazi.

12. “Material mbjellës bimor shumëzimi” është materiali bimor që përdoret për shtimin e tij të mëtejshëm.

13. “Farë” është ovula e pjekur dhe pjellore që përmban embrionin e prodhuar nga bimë që kanë lulëzuar, si dhe pjesë të bimës si tubere, bulba etj., që shërbejnë për të dhënë një ose disa bimë të reja.

14. “Fidan” është një bimë e re e drufrutorëve dhe drurëve pyjorë e dekorativë që ka pjesën

nëntokësore (rrënjët) dhe pjesën mbitokësore (trupin) e ardhur nga mbirja e farave, nga shpërthimi i sythave të vendosur në rrënjë, nga kamza dhe nga rrënjëzimi i pjesëve mbitokësore (copa, kalema, lastunja etj.) e cila shërben për mbjellje.

15. “Fidan i shartuar” është një bimë e formuar nga dy pjesë bimore të bashkuara nëpërmjet shartimit, pjesa nëntokësore e së cilës është prodhuar me një nga mënyrat e përshkruara në pikën 14 dhe pjesa mbitokësore e formuar nga një kalem ose syth i marrë nga një bimë tjetër, e cila ruan cilësitë e bimës nga është marrë.

16. “Riprodhim” është prodhimi i një ose më shumë bimëve ose materialeve mbjellëse bimore nëpërmjet shumëzimit seksual dhe/ose vegjetativ.

17. “Regjistri Themeltar i specieve dhe varieteteve të bimëve bujqësore të kultivuara dhe bimëve pyjore e dekorative” është regjistri ku mbahen të shënuara të gjitha speciet, varietetet, kultivarët e hibridet që janë përdorur, përdoren dhe që futen përsëri në prodhim, sipas rregullave të vendosura.

18. “Shumëzim” është procesi i shtimit të materialeve mbjellëse bimore.

19. “Testim” janë provat krahasuese, që kryhen në dy e më shumë zona, për të vërtetuar aftësitë prodhuese dhe cilësore të një varieteti, kultivari, hibridi ose kloni.

20. “Varietetet” janë një grup bimësh të së njëjtës specie që kanë karakteristika të njëjta.

## KREU II

### KRIJIMI, RIPRODHIMI DHE SHUMËZIMI I MATERIALIT MBJELLËS BIMOR

#### Neni 3

Kanë të drejtë të krijojnë material mbjellës të ri bimor për përhapje dhe tregtim, institucionet kërkimore-shkencore e arsimore, shtetërore e private dhe të gjithë personat e tjerë fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 4

Krijuesit e çdo materiali të ri mbjellës bimor i njihet e drejta e autorësisë dhe e pronësisë me vendim të Komisionit Shtetëror të Atestimit të Varieteteve. Vendimet e këtij Komisioni shpallen nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

U njihet e drejta e autorësisë dhe e pronësisë të gjithë autorëve ose bashkautorëve që janë shpallur si të tillë, me vendim të Komisionit të Atestimit të kultivarëve dhe hibrideve të rinj dhe që janë regjistruar në Katalogun Zyrtar të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve.

Për të njohur autorësinë dhe pronësinë për materialet mbjellëse bimore të rinj ndiqen procedurat e mëposhtme:

a) Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve organizon dhe/ose mbikëqyr kryerjen e provave të testimit, që kryhen vetë ose nga institucione të tjera të vendit, shtetërore ose private, që janë të pajisura me leje nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit për kryerjen e kësaj veprimtarie.

b) Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, vetë ose në bashkëpunim me institucionet që kanë kryer provat e testimit, në përfundim të tyre, i bën propozimin me shkrim Komisionit Shtetëror të Atestimit të Varieteteve.

c) Komisioni Shtetëror i Atestimit të Varieteteve shqyrton propozimin e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve, si dhe raportin përfundimtar të provave të testimit. Pas kualifikimit të materialeve mbjellëse bimore, ky komision i propozon Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit njohjen e autorësisë dhe të pronësisë.

ç) Të drejtat e autorësisë rregullohen me ligj të veçantë.

#### Neni 5

Riprodhimi dhe shumëzimi i çdo kategorie të materialit mbjellës bimor lejohet të bëhet nga çdo krijues i materialit të ri mbjellës, nga institucionet kërkimore-shkencore dhe arsimore-shtetërore ose private dhe të gjithë personat e tjerë fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, me kusht që:

- a) të merret leje ose autorizim nga pronari nëse varieteti është me pronësi;
- b) të disponohet dokumenti që vërteton origjinën e materialit fillestar, farë ose materiale shumëzimi vegjetativ;
- c) materiali mbjellës bimor që riprodhohet dhe shumëzohet, të jetë i regjistruar në Katalogun Zyrtar të specieve dhe varieteteve, në listën “A” ose “B”, përjashtuar farat e perimeve dhe të luleve;
- ç) të sigurohet zbatimi i kushteve të domosdoshme teknike për riprodhimin dhe shumëzimin e materialit mbjellës bimor, të përcaktuara me akte nënligjore të Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve;
- d) të merret leje nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, i cili brenda një afati prej 45 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës nga subjekti përkatës, duhet t’i kthejë përgjigje, në të kundërt leja do të konsiderohet e dhënë automatikisht.

Kriteret e dhënies së lejes për riprodhimin dhe shumëzimin e materialit mbjellës bimor përcaktohen me akte të veçanta të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

#### Neni 6

Lejohet riprodhimi dhe shumëzimi i materialit mbjellës bimor, të paregjistruar në Katalogun Zyrtar të specieve dhe varieteteve për persona fizikë dhe juridikë të huaj, me drejtim përdorimin jashtë territorit të Shqipërisë, me përjashtim të riprodhimit dhe të shumëzimit të materialeve mbjellëse bimore, të ndaluara me ligj.

### KREU III TREGTIMI I MATERIALIT MBJELLËS BIMOR

#### Neni 7

Lejohet të tregtojnë material mbjellës bimor, personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, të pajisur me leje për të ushtruar veprimtari tregtare nga organet përkatëse gjyqësore, sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 8

Lejohet të tregtohet material mbjellës bimor kur:

- a) i përket specieve bimore dhe varieteteve (kultivarë, hidrid dhe klone) të tyre, që janë regjistruar në listën “A” dhe “B” të Katalogut Zyrtar të specieve dhe varieteteve, përjashtuar farat e perimeve dhe luleve;
- b) është i pajisur me deklaratën e konfirmimit sipas specifikimeve teknike, në përputhje me ligjin nr.8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin”;
- c) disponohen dokumente që vërtetojnë origjinën e materialit mbjellës bimor që tregtohet;
- ç) disponohet certifikata e analizave laboratorike e lëshuar nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe laboratorë të tjerë të autorizuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

Për rastet e materialeve mbjellëse bimore, që importohen dhe futen për herë të parë në tregun shqiptar, përveç kërkesave të mësipërme, të shoqërohen dhe me dokumentacionin e nevojshëm për zonat e përhapjes dhe teknikën e kultivimit.

Në raste të jashtëzakonshme dhe të fatkeqësive natyrore për lloje dhe kontigjente të caktuara të materialit mbjellës bimor, me vendim të Këshillit të Ministrave, lejohet tregtimi dhe mbjellja e materialit mbjellës bimor, me tregues cilësorë të paparashikuar në standardet shqiptare.

#### Neni 9

Kriteret dhe rregullat e përpunimit, ambalazhimit, ruajtjes, etiketimit dhe përmbajtjes së etiketës për materialet mbjellëse bimore, të prodhuara brenda vendit, për tregtim të brendshëm, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 10

Institucionet shkencore dhe arsimore, Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, si dhe subjekte të tjera që merren me krijimin dhe ruajtjen e materialit mbjellës bimor, vetëm me urdhër të titullarit të institucionit kanë të drejtë të shkëmbejnë material mbjellës bimor në sasi të vogla për qëllime shkencore dhe eksperimentale me institucionet shkencore jashtë vendit ose me persona fizikë dhe juridikë të huaj, pa iu nënshtruar procedurave doganore.

Kufijtë e sasive të farave sipas llojeve, që lejohen të shkëmbehen për këtë qëllim, si dhe ato që ndalohen, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### KREU IV PROCEDURAT E KONTROLLIT DHE TË VLERËSIMIT CILËSOR TË MATERIALIT MBJELLËS BIMOR

##### Neni 11

Në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit vepron Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve, i njësuar me drejtoritë e dikasterit, i cili përgjigjet për:

a) organizimin dhe kryerjen e provave të testimit të materialeve mbjellëse bimore të reja, të krijuara dhe/ose të importuara, vetë dhe/ose me mbikëqyrës;

b) kryerjen e analizave laboratorike zyrtare për treguesit cilësorë të materialeve mbjellëse bimore. Këto analiza kryhen në Laboratorin e Entit Shtetëror të Farave e Fidanëve dhe laboratorë të tjerë të autorizuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit. Treguesit cilësorë të materialeve mbjellëse bimore, që analizohen, përcaktohen nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit;

c) organizimin e grumbullimit, të ruajtjes, ripërtëritjes, studimit, vlerësimit dhe këmbimit të germoplazmës bimore të vendit nëpërmjet institucionit të bankës gjenetike;

ç) mbajtjen dhe plotësimin e vazhdueshëm të Regjistrit Themeltar dhe të Katalogut Zyrtar të specieve dhe varieteteve. Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit shton ose heq varietete në Katalogun Zyrtar të specieve dhe të varieteteve të bimëve bujqësore të kultivuara e të bimëve pyjore e dekorative, mbi bazën e vendimit të Komisionit Shtetëror të Atestimit të Varieteteve;

d) integrimin dhe anëtarësimin e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë që merren me trajtimin e materialit mbjellës bimor, si dhe me organizma homologë të vendeve të tjera;

dh) kontrollin e zbatimit të rregullave dhe kriterëve të vendosura në këtë ligj dhe në aktet nënligjore për krijimin, riprodhimin, shumëzimin, tregtimin dhe importimin e materialit mbjellës bimor, për të cilin funksionon Inspektorati i Kontrollit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve. Të drejtat dhe detyrat e tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

e) certifikimin e materialeve mbjellëse bimore, vetë ose nga agjenci private. Organizimin dhe procedurat e kryerjes së certifikimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me akte të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit;

Funksionimi, të drejtat dhe detyrat e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe akte të tjera që nxjerr Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit në zbatim të këtij ligji.

##### Neni 12

Testimi i materialeve mbjellëse bimore bëhet në mënyrë vullnetare.

##### Neni 13

Për vlerësimin dhe kualifikimin e materialit mbjellës bimor, funksionon Komisioni Shtetëror i Atestimit të Varieteteve. Përbërja dhe përgjegjësitë e këtij Komisioni caktohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

#### KREU V KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

#### Neni 14

Sipas këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e dispozitave të parashikuara për:

a) shumëzimin dhe riprodhimin e materialeve mbjellëse bimore në kundërshtim me nenet 5 e 6 të këtij ligji. Përfshihen nga detyrimet që rrjedhin nga ky nen personat që prodhojnë materiale mbjellëse bimore me porosi të personave fizikë e juridikë vendas dhe të huaj. Në këtë rast përgjegjësitë ligjore bien mbi porositësin;

b) tregtimin e materialeve mbjellëse bimore në kundërshtim me nenin 8 të këtij ligji.

#### Neni 15

##### **Ndëshkimet**

Për kundërvajtjet e parashikuara në nenin 14 të këtij ligji nga organet e kontrollit të parashikuara në nenin 16 të këtij ligji, jepen këto ndëshkime:

Për shkeljet e parashikuara në pikën 1:

Vihet 50-300 mijë lekë gjobë për shkeljet që parashikohen në shkronjën “d” të nenit 5 të këtij ligji dhe bllokim deri në plotësimin e kërkesave ligjore. Për shkeljet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të nenit 5 dhe nenit 6 të këtij ligji, merret masë sekuestrimi dhe asgjësimi i materialit të mbjellë dhe të prodhuar ose kalimi për konsum për rastet kur prodhimi është i konsumueshëm.

b) Për shkeljet e parashikuara në pikën 2:

Merret masë sekuestrimi, asgjësimi ose kalim për konsum, kur materiali është i konsumueshëm, përse parashikohet në shkronjat “a”, “b” dhe “ç” të nenit 8 dhe gjobë 20-30 mijë lekë për çdo 100 mijë lekë të vlerës së sasisë të materialit mbjellës bimor dhe bllokim deri në plotësimin e kërkesave ligjore, përse parashikohet në shkronjat “c” dhe “ç” të nenit 8.

#### Neni 16

1. Organet që kanë të drejtë të vendosin masa administrative janë:

a) Kryeinspektori i farave e fidanëve, inspektori i këtij inspektorati, si dhe çdo person tjetër i autorizuar nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit, për vendosjen e masës së gjobës dhe të bllokimit.

b) Kryeinspektori i farave e fidanëve për masën e sekuestrimit, të asgjësimit ose kalimit për konsum, kur materiali mbjellës bimor përcaktohet i konsumueshëm; për këtë qëllim ngrihet një komision vlerësues nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve.

2. Kundër vendimit të dhënë nga inspektori bëhet ankesë me shkrim brenda 10 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit të Kryeinspektori i farave e fidanëve. Kundër vendimit të dhënë nga Kryeinspektori i farave dhe i fidanëve bëhet ankesë me shkrim brenda 10 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit të Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.

3. Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masës administrative bëhen në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

### KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

#### Neni 17

Ngarkohen Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet përkatëse në zbatim të nenit 8, 9, 10 dhe 11 dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit në zbatim të neneve 4, 5, 8, 11 dhe 13.

#### Neni 18

Ligji nr.7659, datë 12.1.1993 “Për farat dhe fidanët”, si dhe çdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2895, datë 9.2.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Rexhep Meidani**